



Prishtinë, 29 mars 2018
Kodi i ZRRE-së: V_939_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 14 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_855_2016 të datës 11 nëntor 2016 të lëshuar shoqërisë "Hidro Forca" Sh.p.k., me të cilën ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lokacionin HC Soponica 2, ZK Soponicë, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, Komuna e Kaçanikut, Republika e Kosovës, dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lokacionin HC Soponica 2, ZK Soponicë, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, Komuna e Kaçanikut, të datës 03.11.2017, të shoqërisë "Hidro Forca" Sh.p.k., me adresë: rruga e "Mentoj Tolaj" nr. 87, Deçan, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 29 mars 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Hidro Forca" Sh.p.k., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_855_2016 i datës 11 nëntor 2016, për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final, për ndërtimin e Hidrocentralit në Lokacionin HC Soponica 2, ZK Soponicë, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, Komuna e Kaçanikut, edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht **deri me 11 maj 2018**.
- II. Shoqëria "Hidro Forca" Sh.p.k., obligohet që brenda këtij afati të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lokacionin HC Soponica 2, ZK Soponicë, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, Komuna e Kaçanikut, gjegjësisht deri me datën **11 maj 2018** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- III. Pas skadimit të afatit të cekur në pikën I. të dispozitivit, Vendimi V_855_2016 i datës 11 nëntor 2016 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.




Arsyetim

- ZRRE, me datë 23.08.2016 nga shoqëria “Hidro Forca” Sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike Hidrocentrali në Lokacionin HC Soponica 2, ZK Soponicë, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, Komuna e Kaçanikut, Republika e Kosovës.
 - ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 11 nëntor 2016 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_855_2016, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t’i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohej me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
 - Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_855_2016, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
 - Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar disponueshmërinë e caqeve si dhe pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse dhe garantimin automatik të tarifës nxitëse.
 - Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar se aplikuesit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Furnizuesit Publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.
 - Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (1) një vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqërisë “Hidro Forca” Sh.p.k., do t’i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
 - Aplikuesi “Hidro Forca” Sh.p.k., me datë 03.11.2017 ka parashtruar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar dhe në kërkesën e saj ka sqaruar se: *arsyeja e vazhdimit të vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin preliminar është se janë në pritje të marrjes së Lejes Ndërtimore nga organi Kompetent i Komunës së Kaçanikut, dhe vonesa për mos pajisje me Leje ndërtimore ka ardhur si pasojë e mos-funksionalizimit të Asamblesë së Komunës të cilët nuk janë të konstituuar si rrjedhojë e zgjedhjeve komunale.*
 - *Andaj kanë kërkuar që të shtyhet afati i vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Preliminar edhe për gjashtë (6) muaj, dhe brenda kësaj periudhe do të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar për autorizim final.*
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë “Hidro Forca” Sh.p.k., për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Kaçanikut,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së